

VENDIM
Nr. 431, datë 26.6.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 699, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS VJORË’ (SHTESA)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “kullotë”, “pyll”, “dru frutorë”, “ullishte” dhe “pemëtore”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 260 289 121 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e një) lekësh, si më poshtë vijon:

a) Truall, me sipërfaqe 22 555 (njëzet e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) m², me vlerë 234 128 178 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë;

b) Arë, me sipërfaqe 55 316 (pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) m², me vlerë 11 284 464 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë;

c) Kullotë, me sipërfaqe 19 639 (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) m², me vlerë 3 948 628 (tre milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë;

ç) Pyll, me sipërfaqe 4 187 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², me vlerë 690 855 (gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë;

d) Dru frutorë, me vlerë 6 732 500 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë;

dh) Ullishte, me sipërfaqe 11 681 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) m², me vlerë 3 134 644 (tre milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë;

e) Pemëtore, me sipërfaqe 1 813 (një mijë e tetëqind e trembëdhjetë) m², me vlerë 369 852 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.”.

b) Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në fjalinë e parë, pas fjalëve “dru frutorë” shtohet fjala “pemëtore”;

ii. Shuma “254 524 689 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e pesëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë” zëvendësohet me “260 289 121 (dyqind e gjashtëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë” dhe shumën “234 390 718 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë” zëvendësohet me “240 155 150 (dyqind e dyzet milionë e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shitesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 699, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS VLORE’ (SHITESA)”, I NDRYSHUAR

NR.	TË DHËNAT E PRONËSISË			TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË						VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (D+E) (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
										Çmimi lek/ m ²	Vlera (lek)	Drufrutor	VLERA TOTALE (lekë)	
	Emri	Afësia	Mbiemri	Adresa bashkia ose fshati	ZK	Nr. pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e shprorësuar	Lloji i pasurisë					
1	LULËZIM	MUISI	FEJZAJ	KANINË	2074	548/1/5	5200	228	Ullishte	204	46,512.00		46,512.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës nr. 646/1 prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur nuk ka të mbijella pemtore.
2	MYRVETE		ITAJ	KANINË	2074	548/2/1	6880	1188	Ullishte	204	242,352.00		242,352.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës nr. 646/1 prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur nuk ka të mbijella pemtore.
3	BEZHAN	HABIL	KODHIMAJ	KANINË	2074	548/8	4000	1415	Ullishte	204	288,660.00		288,660.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës nr. 646/1 prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur nuk ka të mbijella pemtore.
4	PANDELI	XHEZAIR	XHEZAIRAJ	KANINË	2074	373/3/3	2530	1813	Pemtore	204	369,852.00		369,852.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës Nr. 646/1 Prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur nuk ka të mbijella pemtore.
5	AFRIM		AGALLIU	VLORË	8605	6/246	4992	414	Truall	8300	3,436,200.00		3,436,200.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës nr. 646/1 prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur nuk ka të mbijella pemtore.
	DASHAMIR		AGALLIU											
	TEFERI	KUJTIM	CAUSHAJ											
	MARJANA		DRASA											
6	ARDIAN		KOLO	KANINË	2074	936/1	1536	257	Ullishte	204	52,428.00		52,428.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës nr. 646/1 prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur nuk ka të mbijella pemtore.
7	PETRIT		MICAJ	KANINË	2074	952	4200	2057	Ullishte	204	419,628.00	908,800.0	1,328,428.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkrësës nr. 646/1 prot., datë 18.12.2023, të AIREB Lushnjë dhe procesverbalit bashkëdhëbur, pasuria nr. 952, ka të mbijella pemtore të vlerësuar në vlerën 908800 lekë.
	Vlera totale												5,764,432.00	